

MESAZHI

I ATIT TË SHENJTË

FRANÇESKUT

PËR KREMTIMIN E

DITËS SË 51-të BOTËRORE

TË PAQES

1 JANAR 2018

Enti Botues
Arqipeshkvia Metropolitane
Shkodër-Pult

Shkodër 2017

Përkthyesë
Angjelina Gjeka

Redaktore
Loreta Toma

Faqosja dhe grafikat
Luigj Mila

© *Copyright*
Arqipeshkvia Shkodër-Pult

© *Copyright originali*
Libreria Editrice Vaticana

MIGRANTËT DHE REFUGJATËT: BURRA E GRA NË KËRKIM TË PAQES

1. Urim paqeje

Paqe të gjithë personave dhe të gjitha kombeve të tokës! Paqja, që engjëjt u lajmërojnë barinjve natën e Krishtlindjes,¹ është një aspiratë e thellë e të gjithë personave dhe e të gjithë popujve, sidomos e atyre që në mënyrë më të rëndë e vuajnë mungesën e saj. Mes këtyre, që i bart në mendimet e mia dhe në lutjen time, dua edhe një herë të kujtoj më se 250 milionë migrantët në botë, nga të cilët 22 milionë e gjysmë janë refugjatë. Këta të fundit, sikurse ka pohuar paraardhësi im i dashur Benedikti XVI, «janë burra e gra, fëmijë, të rinj dhe të moshuar që kërkojnë një vend ku të jetojnë në paqe».²Për ta

¹ Luka 2,14.

² Angelus, 15 janar 2012.

gjetur atë, shumë prej tyre janë të gatshëm të rrezikojnë jetën në një udhëtim, që në më të shumtën e rasteve është i gjatë dhe i rrezikshëm, të pësojnë mundime e vuajtje, të përballojnë rrethime e mure të ngritura për t'i mbajtur ata larg këtij pikësynimi.

Me shpirt mëshire, i përqafojmë të gjithë ata që ikin prej luftës e prej urisë ose që janë të detyruar t'i lënë tokat e tyre për shkak të diskriminimeve, përndjekjeve, varfërisë dhe degradimit mjedisor.

Jemi të vetëdijsëm se nuk mjafton t'i hapim zemrat tona përpara vuajtjes së të tjerëve. Duhet bërë ende shumë përpara se vëllezërit tanë dhe motrat tona të jetojnë përsëri në paqe, në një shtëpi të sigurt. Mikpritja e tjetrit kërkon një angazhim konkret, një zinxhir ndihmesh e dashamirësie, një vëmendje syçelët dhe të kuptueshme, administrimin e përgjegjshëm të situatave të reja komplekse që, nganjëherë, u shtohen problemeve të tjera dhe të shumta që ekzistojnë, si edhe të burimeve që janë gjithmonë të kufizuara. Duke praktikuar virtytin e maturisë, qeveritarët do të dinë të mikpresin, të

nxisin, të mbrojnë dhe të integrojnë, duke caktuar masa praktike, «në kufijtë e lejuar prej të mirës së përbashkët të kuptuar drejt, [për] të mundësuar këtë përfshirje».³ Ata kanë një përgjegjësi të mirëpërcaktuar ndaj bashkësive të veta, të cilave duhet t'u sigurojnë të drejtat e duhura dhe zhvillimin harmonik, për të mos qenë si ndërtuesi i marrë, që i bëri keq llogaritë dhe nuk arriti ta përfundonte kullën që kishte filluar të ndërtonte.⁴

2. Pse kaq shumë refugjatë dhe migrantë?

Në përgatitje të Jubileut të Madh për dymijëvjetorin e kumtimit të paqes prej engjëjve në Betlehem, Shën Gjon Pali II përmendi numrin në rritje të të ikurve mes pasojave të «një vazhde të pafundme dhe të tmerrshme luftërash, konfliktesh, genocidesh, “spastrimesh etnike”»,⁵ që kishin karakterizuar shekullin XX. Shekulli i ri deri tani nuk ka shënuar një kthesë të vërtetë: konfliktet e armatosura dhe format e tjera të dhunës së organizuar

³. Gjoni XXIII, Let. enc. *Paqe në tokë*, 57.

⁴. Krh. Luka 14, 28-30.

⁵. Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 2000, 3.

vazhdojnë të shkaktojnë zhvendosje popullatash brenda kufijve kombëtarë dhe përtej tyre.

Por personat migrojnë edhe për arsye të tjera, e para ndër të gjitha «dëshira për një jetë më të mirë, e bashkuar shumë herë me përpjekjen për të lënë pas krahëve “dëshpërimin” e një të ardhmeje të pamundur për t’u ndërtuar».⁶ Njerëzit nisen për t’u bashkuar me familjen e tyre, për të gjetur mundësi pune apo shkollimi: ai që nuk mund t’i gëzojë këto të drejta, nuk jeton në paqe. Gjithashtu, siç kam theksuar në Enciklikën *Ti qofsh lëvduar*, «është tragjik shtimi i migrantëve që ikin nga mjerimi i rënduar prej degradimit mjedisor».⁷

Pjesa më e madhe migron duke ndjekur një rrugëtim të rregullt, ndërsa disa marrin rrugë të tjera, sidomos për shkak të dëshpërimit, kur atdheu nuk u jep atyre as siguri e as mundësi dhe çdo rrugë e ligjshme duket e pamundur, e bllokuar apo tepër e ngadaltë.

⁶ Benedikti XVI, Mesazhi për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2013.

⁷ Nr. 25.

Në shumë Vende ku ata duan të shkojnë është përhapur gjerësisht një retorikë që emfatizon rreziqet për sigurinë kombëtare apo peshën e mikpritjes së të mbërriturve të rinj, duke përbuzur kështu dinjitetin njerëzor që duhet t'u njihet të gjithëve, si bij dhe bija të Hyjit. Ata që thonë se duhet të kemi frikë prej migrantëve, ndoshta për qëllime politike, në vend që të ndërtojnë paqen, mbjellin dhunë, diskriminim racor dhe ksenofobi, që janë burim i madh shqetësimi për të gjithë ata që kanë për zemër mbrojtjen e çdo qenieje njerëzore.⁸

Të gjitha elementet që ka bashkësia ndërkombëtare tregojnë se migrimet globale do të vazhdojnë ta karakterizojnë të ardhmen tonë. Disa i konsiderojnë si një kërcënim. Ndërsa unë ju ftoj t'i shihni me një vështrim plot besim, si mundësi për të ndërtuar një të ardhme paqeje.

3. Me vështrim soditës

Urtia e fesë e ushqen këtë vështrim, të aftë të kuptojë se të gjithë janë «pjesë

⁸. Krh. Fjalim drejtuar Drejtorëve kombëtarë të baritores për migrantët pjesëmarrës në Takimin e nxitur nga Këshilli i Konferencave Ipeshkvnore të Europës (KKIE), 22.09.2017.

e një familjeje të vetme, migrantët dhe popullatat vendore që i mikpresin ata, dhe të gjithë kanë të njëjtën të drejtë t'i përdorin të mirat e tokës, pasi janë për të gjithë, siç mëson doktrina shoqërore e Kishës. Këtu e kanë themelin solidariteti dhe bashkëndarja».⁹ Këto fjalë na riparaqesin shëmbëlltyrën e Jerusalemit të ri. Libri i Isaisë profet (kap. 60) dhe pastaj ai i Zbulesës (kap. 21) e përshkruajnë si një qytet me dyer gjithmonë të hapura, me qëllim që të hyjnë njerëz të çdo kombi, që e admirojnë dhe e mbushin me pasuri atë. Paqja është sovrani që e udhëheq dhe drejtësia parimi që drejton bashkëjetesën brenda tij.

Kemi nevojë që ta hedhim edhe nga qyteti ku jetojmë këtë vështrim soditës, «domethënë një vështrim feje që na zbulon atë Hyj që banon në shtëpitë e tij, në rrugët e tij, në sheshet e tij [...] duke nxitur solidaritetin, vëllazërinë, dëshirën për të mirën, për të vërtetën, për drejtësinë»,¹⁰ me fjalë të tjera, duke realizuar premtimin e paqes.

⁹ Benedikti XVI, Mesazhi për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2011.

¹⁰ Nxit. ap. Gëzimi i Ungjillit, 71.

Duke vërejtur migrantët dhe refugjatët, ky vështrim do të dijë të na zbulojë se ata nuk vijnë duarbosh: sjellin një ngarkesë guximi, aftësie, energjish dhe aspiratash, përveç pasurive të kulturave të tyre të prejardhjes, duke pasuruar në këtë mënyrë pasurojnë jetën e kombeve që i mikpresin. Do të dijë të na bëjë të dallojmë edhe krijimtarinë, këmbënguljen dhe shpirtin e sakrificës së personave të panumërt, të familjeve dhe të bashkësive që në të gjitha anët e botës u hapin derën dhe zemrën migrantëve e refugjatëve, edhe aty ku burimet nuk janë të bollshme.

Në fund, ky vështrim soditës do të dijë ta drejtojë shohitjen e përgjegjësve të punëve publike, në mënyrë që t'i nxisë politikat e mikpritjes deri në maksimumin e «kufijve të lejuar prej së mirës së përbashkët të kuptuar drejt»,¹¹ pra duke vlerësuar nevojat e të gjithë anëtarëve të së vetmes familje njerëzore dhe të mirën e secilit prej tyre.

Ai që frymëzohet prej këtij vështrimi do të jetë në gjendje t'i njohë sythas e paqes që

¹¹ Gjoni XXIII, Let. enc. *Paqe në tokë*, 57.

tashmë janë duke çelur dhe do të kujdeset për rritjen e tyre. Kështu do t'i kthejë në kantiere paqeje qytetet tona, shpesh të ndara e të polarizuara nga konflikte që kanë lidhje pikërisht me praninë e migrantëve dhe të refugjatëve.

4. Katër gurë këndi për veprimin

T'u japim atyre që kërkojnë strehim, refugjatëve, migrantëve dhe viktimave të shitblerjes së qenieve njerëzore, mundësinë që gjejnë atë paqe që janë duke kërkuar, lyp një strategji që kombinon katër veprime: mikpritjen, mbrojtjen, nxitjen dhe integrimin.¹²

“Mikpritja” na kujton nevojën për t'i zgjeruar mundësitë e hyrjes së ligjshme, për të mos i dëbuar të ikurit dhe migrantët drejt vendeve ku i presin përndjekje e dhunë, si edhe për të bilancuar shqetësimin për sigurinë kombëtare me mbrojtjen e të drejtave themelore njerëzore. Shkrimi i shenjtë na kujton: «Mos e lini pas dore mikpritjen, sepse me anë të saj, disa, pa ditur, pritën miq engjëjt».¹³

¹² Mesazhi për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2018, 15 gusht 2017.

¹³ Hebrenjve 13,2.

“Mbrotja” na kujton detyrën për të njohur e mbrojtur dinjitetin e pacenueshëm të atyre që ikin nga një rrezik real në kërkim të strehimit e të sigurisë, për të penguar shfrytëzimin e tyre. Mendoj veçanërisht për gratë dhe fëmijët, që gjenden në situata ku mund të ndeshin rreziqe e abuzime të tilla që mund t’i kthejnë në skllëvër. Hyji nuk diskriminon: «Zoti i mbron ardhacakët, u ndihmon bonjakëve e të vejave».¹⁴

“Nxitja” i referohet mbështetjes dhe zhvillimit njerëzor të tërësishëm të migrantëve dhe të refugjatëve. Mes mjeteve të shumta që mund të ndihmojnë në këtë detyrë, dëshiroj të theksoj rëndësinë që t’u sigurohet fëmijëve dhe të rinjve mundësia për të ndjekur shkollën: në këtë mënyrë ata jo vetëm do të kultivojnë dhe do të fusin në punë aftësitë e tyre, por edhe do të jenë më shumë në gjendje të ndihmojnë të tjerët, duke kultivuar një shpirt dialogu në vend të mbylljes dhe të përplasjes. Bibla na mëson se Hyji «e do të ardhurin, i jep ushqimin dhe veshën»; prandaj nxit: «Kini edhe ju dashuri për të ardhurin, sepse edhe ju keni

¹⁴ Psalmi 146,9.

qenë të ardhur në dheun e Egjiptit».¹⁵

“Integrim”, në fund, do të thotë t’u mundësohet refugjatëve e migrantëve që të marrin pjesë plotësisht në jetën e shoqërisë që i mikpret, në një dinamikë pasurimi të ndërsjellë dhe bashkëpunimi të frytshëm në nxitjen e zhvillimit të tërësishëm njerëzor të bashkësive vendore. Sikurse shkruan Shën Pali: «Prandaj, nuk jeni më të huaj e mërgimtarë, por jeni bashkëqytetarë të shenjtërve dhe anëtarë të familjes së Hyjit».¹⁶

5. Një propozim për dy Marrëveshje ndërkombëtare.

Uroj me gjithë zemër që të jetë ky shpirti që gjallëron procesin që gjatë vitit 2018 do të çojë në hartimit dhe miratimin nga ana e Kombeve të Bashkuara të dy marrëveshje globale, një për migrimet e sigurta, të kërkuara e të rregullta, tjetri në lidhje me refugjatët. Duke qenë të bashkëndara në nivel global, këto marrëveshje do të përfaqësojnë një kuadër referimi për propozimet politike dhe masat

¹⁵ Ligji i përtërirë 10,18-19.

¹⁶ Efesianëve 2,19.

praktike. Prandaj është e rëndësishme që të frymëzohen nga dhembshuria, largpamësia e guximi, në mënyrë që të shfrytëzohet çdo rast për të vijuar me ndërtimin e paqes: vetëm kështu realizmi i nevojshëm i politikës ndërkombëtare nuk do të bëhet një dorëzim para cinizmit dhe globalizimit të indiferencës.

Në të vërtetë, dialogu dhe koordinimi përbëjnë një nevojë dhe një detyrë të vetë bashkësisë ndërkombëtare. Jashtë kufijve kombëtarë, është e mundur edhe që Vende më pak të pasura të mikpresin një numër më të madh refugjatësh, ose për t'i pritur më mirë, nëse bashkëveprimi ndërkombëtar u siguron atyre gatishmërinë e fondeve të nevojshme.

Seksioni i Migrantëve dhe i Refugjatëve të Dikasterit për Shërbimin dhe Zhvillimin të Tërësishëm Njerëzor ka sugjeruar 20 pika veprimi¹⁷ si pista konkrete për zbatimin e këtyre katër veprimeve në politikën publike, përveçse në qëndrimin dhe në veprimin e bashkësive të krishtera.

¹⁷. “20 Punti di Azione Pastorale” dhe “20 Punti di Azione per i Patti Globali” (2017); shih edhe Dokumenti OKB A/72/528.

Këto dhe të tjera ndihmesa synojnë të shprehin interesimin e Kishës katolike për procesin që do të çojë në përdorimin e marrëveshjeve të lartpërmendura globale të Kombeve të Bashkuara. Ky interesim është shenjë e një kujdesi më të përgjithshëm baritor, lindur me Kishën dhe vazhduar nëpërmjet veprave të saj të shumta deri në ditët tona.

6. Për shtëpinë tonë të përbashkët

Na frymëzojnë fjalët e Shën Gjon Palit II: «Nëse “ëndrra” për një botë paqeje bashkëndahet nga shumë vetë, nëse vlerësohet ndihmesa e migrantëve dhe e refugjatëve, njerëzimi mund të bëhet gjithnjë e më shumë familja e të të gjithëve dhe toka jonë një “shtëpi reale e përbashkët”.¹⁸ Shumë njerëz në histori kanë besuar në këtë “ëndërr” dhe ajo që ata kanë bërë dëshmon se nuk bëhet fjalë për një utopi të përealizueshme.

Mes këtyre duhet përmendur Shenjtja Françeska Saverio Kabrini, 100-vjetori i lindjes së saj në qiell i bie në vitin 2017. Sot, më 13 nëntor, shumë bashkësi

¹⁸. Mesazhi për Ditën Botërore të Migrantit dhe të Refugjatit 2004, 6

kishtare kremtojnë përkujtimin e saj. Kjo grua e vogël e madhe, që ia kushtoi jetën e vet shërbimit të migrantëve, duke u bërë pastaj pajtorja e tyre qiellore, na ka mësuar se si mund t'i mikpresim, mbrojmë, nxisim dhe integrojmë këta vëllezër e motra. Me ndërmjetësinë e saj Zoti bëftë që ne të gjithë të provojmë se «Fryti i drejtësisë mbillet në paqe për ata që punojnë për paqe».¹⁹

Nga Vatikani, 13 nëntor 2017

Përkujtimi i Shenjtes Françeska Saverio Kabrini, Pajtore e migrantëve.

Franchesku

¹⁹. Jakobi 3,18.